



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe
Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja - seksioni dygjuhësh

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve. Për rastet kur përgjigja e nxënësit nuk përshatet plotësisht me përgjigjen në skemë, por afron me logjikën e pyetjes, komisioni i vlerësimit është i detyruar të këshillohet me drejtuesin teknik dhe me specialistët e AVA, për të bërë vlerësimin përfundimtar.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* është specifikuar me kujdes. Vlerësimi i saj do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Lasgush PORADECI****“Poradeci”**

Pyetja 1	C	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	D	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	D	1 pikë

Pyetja 8 **1 pikë****Model përgjigjeje**

Atmosfera që krijohet në dy strofat e para është ajo e paqes dhe qetësisë në një peizazh liqeni, në kohën kur është në përfundim perëndimi i diellit.

1 pikë Nëse shpjegon atmosferën e krijuar në dy vargjet e para.

0 pikë Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

Pyetja 9 **2 pikë**

1 pikë shkrumb’ i natës – metafora është formuar me emër.

1 pikë jeta u dergj - metafora është formuar me folje.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 10 **4 pikë****Model përgjigjeje**

a)

- Retiçenca krijon efektin e qetësisë në mënyrë graduale, deri në heshtje të plotë. Ajo e fton lexuesin të bëhet pjesë aktive e tekstit e t'i mbushë zonat e bardha të tij me interpretime dhe emocione personale. Ajo i bashkon në një proces të vetëm grupin e foljeve, ku përmes një shkallëzimi zbritës, kalon në heshtje të plotë e tërë jeta.
- Aliteracioni: mbizotërojnë bashkëtingëlloret e buta *r, t, j*, të cilat sërish krijojnë idenë e zotërimit të heshtjes në mënyrë graduale deri në qetësi të plotë. Ngjan si një pëshpërimë që shuhet dalëngadalë.

b) *errësira* si si një çast i ditës – kuptimi i drejtpërdrejtë.

Errësira- në kuptim të figurshëm (metaforik) mund të interpretohet si *errësirë* në shpirt, si *errësirë* e kohës, e vendit që vuan ndarjen etnike dhe mungesën e dëshirës për veprim.

Pikë të plota

2 pikë Nëse përshkruan përfytyrimin që krijon retiçenca dhe aliteracioni në dy vargjet e dhëna.

2 pikë Nëse shpjegon fjalën *errësira* në dy kuptimet e saj.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse përshkruan përfytyrimin që krijon retiçenca ose aliteracioni në dy vargjet e dhëna.

1 pikë Nëse shpjegon fjalën *errësira* në një nga kuptimet e saj.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 11 **3 pikë****Model përgjigjeje**a) **Kontrasti**

Ndërsa të gjitha strofat e mësipërme japin idenë e qetësisë, të paqes që zbrit dalëngadalë në natyrë dhe në shoqëri, në dy vargjet e fundit jepet ideja se edhe në qetësinë më të madhe, edhe atje ku mendojmë se ka vetëm vdekje, lëvizja është e pranishme: ajo është vetë jeta që s'vdes kurrë dhe që konkretizohet me lumin që buron për të bërë udhëtimin e tij shekullor.

E gjitha kjo shfaqet në kontrastin e fortë midis:

U dergj – buron

E zuri gjumi – nisi udhëtimin.

b) Shqetësimi dhe dhimbja poetike lidhet me ndarjen dhe bashkimin e dheut (të lashtë) të të parëve. Ajo shpreh më qartë dhe më hapur në dy vargjet e fundit.

Pikë të plota

2 pikë Nëse shpjegon thelbin e kontrastit që krijojnë dy vargjet e fundit me pjesën tjetër të poezisë.

1 pikë Nëse zbulon se me çfarë lidhet shqetësimi i poetit në këtë poezi.

Pikë të pjesshme

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht kontrastin që krijojnë dy vargjet e fundit me pjesën tjetër të poezisë.

OSE

1 pikë Nëse zbulon se me çfarë lidhet shqetësimi i poetit në këtë poezi.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë nuk i përmbahet modelit të përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 12 3 pikë

Model përgjigjeje

a) *i përrallshëm* është mbiemër

b) formimi: me prapashtesë dhe paranyjëzim njëkohësisht OSE
i + përrallë + shëm

c) efekti i shprehësisë: krijon idenë e lashtësisë, të fantazisë, të ëndrrave që burojnë nga thesari popullor.

1 pikë Nëse tregon pjesën e ligjëratës.

1 pikë Nëse gjen formimin e saj.

1 pikë Nëse zbulon efektin e shprehësisë që kjo fjalë krijon.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13 **3 pikë****Model përgjigjeje**

Emërtime vendore:

Liqeri, Mal, Lëndinë, Katund

Arsyeja është për të përforcuar stilistikisht toponiminë e tyre.

2 pikë Nëse gjen dy emërtime**DHE****1 pikë** Nëse gjen arsyen e një përdorimi të tillë.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**PJESA II****Shekspir****“Makbethi”****Pyetja 14** **C** **1 pikë****Pyetja 15** **B** **1 pikë****Pyetja 16** **B** **1 pikë****Pyetja 17** **C** **1 pikë****Pyetja 18** **B** **1 pikë****Pyetja 19** **B** **1 pikë****Pyetja 20** **3 pikë****Model përgjigjeje**

Arsyet janë:

- Dunkani është miku i tij
- Dunkani është si babai i tij
- Dunkani është një mbret i mirë
- Dunkani është një mbret i zoti
- Makbethi do të ndëshkohet nga drejtësia

- 3 pikë** Nëse identifikon tri arsye që e çojnë Makbethin të marrë fillimisht vendimin të mos e vrasë mbretin.
- OSE**
- 2 pikë** Nëse identifikon dy arsye që e çojnë Makbethin të marrë fillimisht vendimin të mos e vrasë mbretin.
- OSE**
- 1 pikë** Nëse identifikon një arsye që e çon Makbethin të marrë fillimisht vendimin të mos e vrasë mbretin.
- 0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 21 2 pikë

Model përgjigjeje

a) Reagimi:

Zonja Makbeth reagon ashpër dhe e godet atë në egon e tij mashkullore. Ajo nuk pranon prej tij asnjë shfajësim. Epitete që ajo i vendos janë: i pazoti dhe frikacak (frigaç).

1 pikë Nëse tregon reagimin e Makbeth kundrejt vendimit të të shoqit.

DHE

1 pikë Nëse gjen një epitete që ajo i vendos atij.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 22 2 pikë

Model përgjigjeje

- Imazhi më i fortë që Zonja Makbeth shfaq është ai i një vrasëseje pa asnjë mëshirë, ku ekstremimin e arrin kur tregon se, po të kishte pasur një fëmijë do ta kish vrasur pa asnjë mëshirë, nëse do të kishte qenë i pazoti si ai.
- Zonja Makbeth, me këtë shembull të tmerrshëm konfirmon mungesën e çdo lloj ndjesie njerëzore dhe të çdo lloj emocioni.

1 pikë Nëse tregon imazhin e fortë që krijohet.

DHE

1 pikë Nëse gjen se ç'tregon kjo për të..

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 23 **4 pikë****Model përgjigjeje**

a) Plani kalon në këto etapa:

- Do të dehin rojat.
- U ngarkojnë fajin e vrasjes duke u vënë afër kamat me gjak.
- Do të bërtasin, çirren e vajtojnë për gjëmën e ndodhur.

b) Kur Makbethi thotë: *E kam vendosur*- në fund të kësaj skene, atëherë ne kuptojmë se Zonja Makbeth ka triumfuar përfundimisht.

3 pikë Nëse identifikon tri etapat e planit të krimit.

DHE

1 pikë Nëse zbulon momentin kur Zonja Makbeth triumfon.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 24 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Makbethi tashmë është bindur dhe shfaqet i vendosur. Ai vesh mantelin e vrasësit. Dy vargjet e fundit e shfaqin atë hipokrit dhe të thyer përfundimisht nga e shoqja. Në sytë e saj ai fiton burrërinë, por në sytë e spektatorëve ai shfaq dobësinë e tij.

2 pikë Nëse shpjegon se si shfaqet Makbethi në fund të kësaj skene.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon pjesërisht se si shfaqet ai.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 25 **8 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese ku argumenton se deri në ç' masë Zonja Makbeth është fajtores për rënien e të shoqit.
- përqendrohet në disa nga momentet më thelbësore të marrëdhënieve të çiftit në skenën e dhënë dhe përgjatë tragjedisë.
- i mbështet idetë e veta me shembuj nga poezia.
- përdor detaje mbështetëse.
- ka qartësi mendimi.

KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË**2 pikë****1 pikë** **Struktura e esesë**

- respekton elementet e strukturës së esesë:
 hyrjen
 zhvillimin
 përfundimin

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigjen e dhënë e strukturon sipas skemës së mësipërme.

Nëse mungon njëra prej tyre, ai do të marrë 0 pikë për këtë rubrikë.

1 pikë **Organizimi i esesë**

- organizim logjik, ku shfrytëzohen teknika të tilla si koherenca dhe unifikimi i paragrafëve (lidhja logjike mes paragrafëve, kalimi në mënyrë të natyrshme).

KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI**2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE**2 pikë****(1 pikë sintaksa dhe 1 pikë drejtshkrimi)**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.